



Pranim / Dorezuar Priljeno/Predato Received/ Delivered	16.09.2022	2	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Jednica Org /Unit	Ur Prot Ur Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMBHCK	5472/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.640/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën numër A.nr.640/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

me adresë banimi:

Komuna e Zveçanit, kundër Vendimit

Nr.09/2022 të Komisionit Disiplinor të datës 20.06.2022 si dhe Vendimit nr.336 i datës 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.640/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETEN në fuqi Vendimi Nr.09/2022 i Komisionit Disiplinor të datës 20.06.2022 si dhe Vendimi Nr.336 i datës 24.06.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi pas shkresave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, kundër Vendimit Nr.09/2022 të Komisionit Disiplinor të datës 20.06.2022 si dhe Vendimit nr.336 i datës 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës ka parashtruar ankesë nëpërmjet poste me datë 19.07.2022 e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë:21.07 dhe numër protokolli:4225/2022.

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se Vendimit Nr.09/2022 të Komisionit Disiplinor të datës 20.06.2022 si dhe Vendimit nr.336 i datës 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës

Tatimore të Kosovës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i padrejtë ngase i njëjti ka qenë në pushim mjekësor duke u trajtuar pasi që ka pësuar, sipas arsytimit, citoj; *"Infrastus myocardii subendocardialis acutus, me diagnozën shoqëruese Hypertensio arterialis essentialis (primaria), ndërsa me datë 15.04.2022, më është kryer interoenimi me implantim stenti në degën OM1"*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 29.07.2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datën 04.08.2022 me numër protokoli 4519/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit të Këshillit me datë 02.09.2022 ka nxjerr Vendimin me shifër VK.nr.87/2022 përmes të cilit lëndës A.nr.640/2022 të datës 21.07.2022 i ka shtyrë afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, për shkak të specifikave të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.07.2022 me numër protokoli:4225/20220 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesi me provat e bashkangjitur për trajtimin mjekësor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.07.2022; Vendimin me shifër VK.nr.87/2022 i datës 02.09.2022 të Kryetarit të këshillit; Përgjigjen në kërkesë e datës 04.08.2022 me shkresat e lëndës dërguara nga Administratat tatimore e Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 10.10.2017 me numër prot:100; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë si datës 19.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 01.03.2019; Shkresën përcjellës të datës 23.05.2022 dërguar nga Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore për Komisionin Disiplinor të ATK-së; E-mailin e datës 23.05.2022 dërguar nga T.M për ankuesin me njoftimin për hapjen ne procedurës disiplinore; Listat e vijueshmërisë në punë për muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor dhe korrik vitit 2022; Vendimin Nr.09/2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 17.06.2022; Vendimin nr.336 i datës 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; E-mailin e datës 20.05.2022 dërguar nga I.I për K.D me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 20.05.2022 dërguar nga S.S për I.I; E-mailin e datës 19.05.2022 dërguar nga T.M për N.H; E-mailin e datës 19.05.2022 dërguar nga N.H për T.M; E-mailin e datës 10.05.2022 dërguar nga N.H për T.M; E-mailin e datës 04.05.2022 dërguar nga N.H për M.S; Listën e daljes me ekspertizë e lëshuar nga Klinika për mjekësi interne KBC e datës 14-15.04.2022; Koronarogrami me numër prot:1872/2022; Raportin e mjekut Specialist i datës 15.04.2022-Beograd; Shkresa-Konziliumi Kardiokirurgjik nga Instituti për sëmundje kardiovaskulare -Dedinje; Vërtetimin për evidencën e regjistrimit të pacientit 234447; Shkresa-Shpenzimet e materialit dhe shërbimet; Lista e daljes me ekspertizë; Vërtetimin mbi testimin e Sars-COV-2; , Shkresa e analizave laboratorike e datës 15.04.2022; Lista e Lëshimit me ekspertizë nga Klinika për Mjekësi Interne "KBC
Vendimin i Kryetari të Këshillit me shifër VK.nr.87/2022 i datës 02.09.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës ka gjetur se ankuesi Marko Savic sipas aktit të emërimit të datës 10.10.2017 me numër protokoli:100 është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, Departamenti: Operacionet, Divizioni: Zyra

Rajonale në Mitrovicë, në pozitën e punës: *Taksambledhës* me afat të pacaktuar, ndërsa Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me datë 17.06.2022 përmes Vendimit Nr.09/2022 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë i ankuesit kishte iniciuar procedurë disiplinore për shkak që ky i fundit kishte munguar më shumë se pesë (5) ditë në punë pa asnjë paralajmërim apo arsyetim. Po ashtu, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore bazuar në kompetencat që burojnë nga detyrat e tij të punës në cilësi të zyrtarit më të lartë të institucionit, me datë 23.06.2022 ka nxjerrë vendimin me numër protokolli:336 i cili e ka konfirmuar masën e shqiptuar ndaj ankuesit ku për bazë ka pas masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor me vendimin Nr.09/2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit gjatë administrimit të provave të lëndës, gjegjësisht listën e vijueshmërisë në punë për muajin janar, shkurt, mars, prill, maj dhe qershor të vitit 2022 të siguruara nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Administratës Tatimore të Kosovës përmes shkresës së datës 04.08.2022, ka konstatuar se ankuesi që nga data 07.03.2022 kur ka qenë i obliguar kë kthehet në punë pas përfundimit të pushimit dhe deri në momentin e inicimit të procedurës disiplinore sipas e-mailit të datës 20.05.2022, ka munguar në punë për katërdhjetë e tetë (48) ditë në mënyrë të pandërprerë, apo nëse llogaritet e gjithë koha deri në ditën e shqiptimit të masës disiplinore me datë 17.06.2022 ankuesi ka munguar në punë gjithsejtë gjashtëdhjetë e shtatë (67) ditë, ndërsa i njëjti me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka ofruar dëshmi, gjegjësisht sipas Raportit të mjekut specialist

nga Instituti për sëmundje kardiovaskular-Dedinje i datës 15.04.2022 Beograd, dëshmohet se ankuesi me datë 13.04.2022 është hospitalizuar në Shtëpinë e Shëndetit në Mitrovicë, ndërsa sipas listës së lëshimit me ekspertizë e datës 19.04.2022 nga Klinika për Mjekësi Interne KBC dëshmohet se ankuesi ka qenë i hospitalizuar në të njëjtën klinikë deri me datë 19.04.2022, ndërsa pas kësaj dite është lëshuar në gjendje të rregullt në shtëpi, mirëpo ankuesi edhe pas kësaj date ka vazhduar të mungojë në punë.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.5 ku përcaktohet se: "*1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë*" si dhe nenin 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;"*" po ashtu ka analizuar edhe nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "*Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. 2. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore*" dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi me veprimin e tij, mungesën në punë dhe mos lajmërimin e mungesës të udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ka kryer veprim të paligjshëm të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë pasi që i njëjti ka munguar më shumë se pesë (5) ditë në punë, gjegjësisht nga datat 07.03.2022 deri në inicimin dhe fillimin e procedurë disiplinore me datë 20.05.2022 ka munguar plotësisht katërdhjetë e tetë (48) ditë në punë,

ndërsa pavarësisht që i njëjti me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ku ka sjellë prova që pretendon të mbështesë arsyetimin e tij për mungesë në punë për arsye shëndetësore, në asnjë pjesë të ankesës dhe me asnjë argument dhe provë bindëse nuk ka arritur të arsyetojë me prova mungesën në punë për njëzetë e gjashtë (26) ditë pune mungesë kjo nga datat 07.03.2022 deri me datë 13.04.2022 përpara se i njëjti të shtrohet për trajtim mjekësor në Shtëpinë e Shëndetit më Mitrovicë dhe po ashtu është për tu theksuar fakti se ankuesi sipas Raportit të mjekut specialist

nga Instituti për sëmundje kardiovaskulare Dedinje i datës 15.04.2022 Beograd, është konstatuar se, *citoj konstatimin e doktorit* se ankuesi: *"Gjatë ekzaminimit është i vetëdijshëm, i orientuar, i kompensuar kardiopulmonalisht, subjektivisht pa ankesa, shprehet se nuk ka pas dhimbje pas infarktit"*, si dhe sipas raportit gjegjësisht listës së lëshimit me ekspertizë e datës 19.04.2022 nga Klinika për Mjekësi Interne KBc

i njëjti është shëruar pas hospitalizimit dhe është lëshuar në gjendje të rregullt në shtëpi me terapi përcjellëse, rrjedhimisht ankuesi pas datës 19.04.2022 ka mundur përmes postës elektronike apo telefonit të njoftojë udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë apo Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me arsyet e mos prezencës në punë, mirëpo një shkresë e tillë zyrtare e cila do të shërbente në cilësi të provës ankuesi nuk e ka ofruar.

Po ashtu, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe ligjshmërisë së akteve të goditura nga ankuesi, Kolegji i Këshillit ka pasur parasysh edhe dispozitat që rregullojnë çështjen e pushimit mjekësor me pagesë sikurse është përcaktuar me Rregulloren Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë neni 11 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *"1. Në rast sëmundje, apo paaftësie të përkohshme në punë, zyrtari publik duhet të informojë brenda ditës mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe paraqitje e arsyetimit të mungesës me dëshminë e organit kompetent mjekësor, 2. Zyrtari publik ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës."*, si dhe paragrafi 6 të nenit 11 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 3 të këtij neni Zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdojë pushimin pa pagesë"*, ndërsa sipas listës së vijueshmërisë në punë për muajin janar dhe shkurt të vitit 2022 të siguruara nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Administratës Tatimore të Kosovës përmes shkresës së datës 04.08.2022, Kolegji ka konstatuar se ankuesi i ka shfrytëzuar njëmbëdhjetë (11) ditë të pushimit mjekësor në periudhën ndërmjet datës 28 janar deri me datë 11 shkurt të vitit 2022 nga njëzetë (20) ditë me pagesë të plotë prej 100% të pagës sa i takojnë brenda një (1) viti kalendarik, andaj ditë e mbetura të pushimit (9 ditë) mjekësor nuk e mbulojnë mungesën në punë prej datës 07.03.2022 deri me datë 17.06.2022 kur i është shqiptuar masë disiplinore në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë e shtatë (67) ditësh - ditë pune dhe po ashtu ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi nëse i njëjti ka parashtruar kërkesë në institucionin punëdhënës me qëllim të shfrytëzimit të drejtës në pushim pa pagesë siç përcaktohet me nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *"Zyrtari publike gëzon të drejtën për pushimi pa pagesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës. 2. Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional; 2.2. shëndetit të tij/saj, apo pjesëtarëve të familjes së ngushtë"* si dhe paragrafi 3 të nenit 14 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Vendimi i dorëzohet pa vonesë Zyrtarit dhe Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore"*.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas administrimit dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe analizimit të dispozitave të ligjit material që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësit e nëpunësit civil, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.09/2022 me datë 17.06.2022 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largimi nga Shërbimi Civil", ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat të cilat ia ka njohur nën 48 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor" pasi që masa e shqiptuar disiplinore është e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, dhe po ashtu e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike pasi që ankuesi me veprim e tij ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës gjegjësisht ka kryer veprim të paligjshëm të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.5 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përderisa zyrtari publik mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit për çdo veprim ose mosveprim siç përcaktohet me nenin 28 i të njëjtit ligj: "Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.640/2022

Flakron Gashi

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

